
 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.59/19	Data: 01.06.2019	

Kuvendi i Komunës në bazë nenit 51. paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008), dhe nenit 8 paragrafi 1. të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.1/2016, për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna, shpall:

K O N K U R S

Për zgjedhjen e pesë (5) anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Shëndetësi

Detyrat dhe përgjegjësit:

- 1) Dhenien e propozimeve për rregullore të ndryshme.
- 2) Hulumtime të ndryshme.
- 3) Japin mendime dhe ide rreth iniciativave të marra nga Kryetari i Komunës, Komitet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushën përkatesë.
- 4) Paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve të Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës.
- 5) Jep propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara në lëminë e shëndetësisë.

Kushtet e pjesëmarrjes:

Të drejtë konkurimi kanë të gjithë personat e moshës madhore, të jenë banor të Komunës së Istogut, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës në këtë komitet.

Procedura e konkurimit:

Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët që i plotësojnë këto kushte.

Shkollimi i kërkuar:

- Diplomë universitare.

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera:

Të ketë aftësi të përgjithshme dhe përvojë në fushën e shëndetësisë.

Kohëzgjatja:

4 vite nga data e themelimit.

Pagesa do të behët sipas: Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.1/2016, për procedurën themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna.

Dokumentet e nevojshme: Dokument identifikimi, Dëshmi të kualifikimeve shkollore, Dëshmi mbi përvojën e punës dhe CV-ja.

Afati i konkursit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Kandidatet do t'i nënshtrohen intervistës nga paneli përzgjedhës i Kuvendit të Komunës dhe me datën e intervistës, do të njoftohen më kohë.

Kandidatët e interesuar mund t'i paraqesin kërkesat për konkurim, çdo ditë pune në Njesinë e Administrimit të Dokumenteve, Kati i I, në ndërtesën e Komunës së Istogut, ku edhe mund të dorëzohen.

Për informata mund të kontaktoni me nr. tel. 038 200 438 53.

Vërejtje: Dokumentat e pakompletuara, si dhe parashtrimi i kërkesave pas skadimit të afatit të përcaktuar nuk do të shqyrtohen.

